



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR SHPLLJEN E HAPJES SË PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR DY POZICIONE TË LIRA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, ka vendosur *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, gjithsej për dy pozicione të lira.*

Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për secilin nga dy pozicionet e lira, janë hapur me Vendimet nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka *shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, për të marrë pjesë në këto procedura ngritjeje në detyrë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kriterëve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, duke e identifikuar atë përmes numrit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues, për secilin nga pozicionet e lira, është është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë. - Ky afat përfundon më datë 15.06.2020.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, për secilin nga pozicionet e lira, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimet e tij nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020.

Kujdes:

- 1) Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret e ligjës, *pavarësisht faktit nëse ka kandiduar me parë në procedura të tjera për ngritjen në detyrë, procedura këto që nuk janë finalizuar ende.*
- 2) Çdo kandidat, në respektim të kufizimit të përcaktuar në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të kandidojë për ngritjen në detyrë *për jo më shumë se tre pozicione të lira, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 28.05.2020¹, qofshin ato edhe në të njëjtën gjykatë.*

Ky njoftim është publikuar më datë 29.05.2020.

¹ Më datë 28.05.2020, përveç dy procedurave për ngritjen në detyrë Në Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur edhe disa procedura për ngritjen në detyrë në gjashtë gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur disa procedura për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.